

VENDIM
Nr.1338, datë 10.10.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË “INXHINIERI
AGRARE – AGROMEKANIZIM”, NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE TË MJEDISIT,
TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË
PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTË PROGRAM, NË VITIN
AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25, 26, 33 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë “Inxhinieri agrare-agromekanizim”, në Fakultetin e Bujqësisë dhe të Mjedisit, të Universitetit Bujqësor të Tiranës, dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit për këtë program, në vitin akademik 2008-2009. Në përfundim të studimeve të ciklit të parë përfitohet diplomë e nivelit të parë, DNP, në degën inxhinieri agrare-agromekanizim.

2. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në këtë program studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, sipas vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

3. Programi i studimit të ciklit të parë realizohet me 180 kredite dhe zgjatja normale e tij është tri vite akademike.

4. Numri i kuotave të pranimit me kohë të plotë të jetë 25.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha